

KUNDERSHTIME ME SHKRIM

Paraqitur, bazuar ne Rregullin nr. 44 të Rregullores së Gjykatës nga

KOMISIONI EUROPIAN

përfaqësuar nga André Bouquet, Hannes Kramer dhe Manuel Kellerbauer, këshilltarët juridikë të Shërbimit të saj Ligjor, duke vepruar si agjentë.

në çështjen nr.58997/18 BESA NIKEHASANI VS SHQIPERISE.

Aplikimi sipas Nenit 34 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNJ) në lidhje me shkëljen e pretenduar të të drejtave të kerkueses për një gjykim të drejtë, për të respektuar jetën private dhe një kompensim efektiv të garantuar me nenet 6 (1), 8 dhe 13 te KEDNJ.

1. Me shkresën e dates 21 nëntor 2019, Gjykata i dha Komisionit Evropian (“Komisioni”), në cilësinë e institucionit që përfaqëson Bashkimin Evropian (“BE”) në procedurat ligjore, lejen për të ndërhyre si palë e tretë në çështjen objekt shqyrtimi.

2. Çështja mund të ketë një rëndësi më të gjerë për procesin gjithëpërfshirës në vazhdim të rivlerësimit të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve shqiptarë, si dhe disa prej inspektorëve të drejtësisë në vend, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjore, bazuar ne integritetin dhe aftësinë e tyre profesionale (“Vetting”) . Për më tepër, kjo është e para në një seri çështjesh të pritura para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (“GJEDNJ”) në të cilat elementët e Vettingut që janë thelbësorë për efektivitetin e tij, mund të kundërshtohen.

3. Komisioni nuk mbështet asnjërin palë në këtë procedurë. Në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Presidenti i Seksionit, Komisioni nuk do të komentojë as faktet dhe as thelbin e çështjes. Përkundrazi, Komisioni do të shprehë pikëpamjet e tij për rëndësinë e Vettingut për procesin e reformës gjyqësore në Shqipëri. Për më tepër, Komisioni do të përshkruajë tiparet kryesore të Vettingut dhe rolin e tij në të, si dhe do të nxjerrë në pah ato elemente që i konsideron thelbësore për efektivitetin e tij dhe për respektimin e të drejtave themelore të subjekteve të rivlerësimit.

I. Rëndësia e Vettingut për Procesin e Reformës në sistemin gjyqësor në Shqipëri.

4. Bazuar në perfundimet e Këshillit Evropian në Qershor 2014, BE i dha Shqipërisë statusin e kandidatit për anëtarësimin në BE. Ndërsa ky status u dha në njohje të përpjekjeve të mëparshme të reformës në Shqipëri, në të njëjtën kohë ky ishte edhe një inkurajim për të filluar reformat e mëtejshme të nevojshme për të përgatitur Shqipërinë për fillimin e negociatave të pranimit me BE. Në këtë kontekst, përparimi i mëtejshëm në fushën e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, të cilat janë vlera thelbësore të BE-së, në pajtim me nenin 2 të Traktatit për BE (TBE), u vendosën në krye të rendit të ditës.

5. Këshilli i BE gjithmone ka qene i mendimit se një reformë e plotë dhe gjithëpërfshirëse gjyqësore ka një rëndësi të madhe për forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe për përparimin e vendit në procesin e integritimit evropian. Në dritën e përparimit të rëndësishëm të arritur nga Shqipëria në zbatimin e reformës së përgjithshme në sistemin gjyqësor, e cila përfshinte ngritjen e strukturave të Vettingut dhe fillimin e procesit të rivlerësimit, Komisioni rekomandoi hapjen e negociatave të pranimit me Shqipërinë. Progresi i vendit në zbatimin e reformës së përgjithshme gjyqësore, përfshirë Vetingun, monitorohet nga afër nga Komisioni dhe vlerësohet çdo vit përmes Komunikimeve të Komisionit për politikën e Zgjerimit të BE-së, dhe raporteve specifike mbi Shqipërinë.

6. Në vitin 2016. Shqipëria miratoi një paketë për një reformë gjithëpërfshirëse dhe të plotë në drejtësi. Ajo synonte të rivendoste besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Reforma në sistemin gjyqësor përbëhet nga dy shtylla: Së pari, ristrukturimi institucional i gjithë gjyqësorit dhe prokurorisë, përfshirë reformën e Gjykatës Kushtetuese dhe krijimin e organeve të reja të gjyqësorit. Së dyti, ngritja e Vettingut duke ndryshuar Kushtetutën shqiptare dhe duke miratuar ligjin Nr.84/2016 për rivlerësimin kalimtar të gjykimeve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë (“Ligji i Vettingut”).

7. Qëllimi i Vetting-ut është të luftojë korrupsionin e përhapur, mungesën e profesionalizmit dhe lidhjet me krimin e organizuar ndërmjet gjyqtarëve dhe prokurorëve, të rivendosë një sistem gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm dhe të rivendosë besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë. Përfshirja e bashkësisë ndërkombëtare u konsiderua thelbësore për besueshmërinë e procesit dhe ajo ishte e përfshirë në Kushtetutën e Shqipërisë.

8. Komisioni vlerëson se Vettingu mund të krijojë tension të konsiderueshëm brenda sistemit gjyqësor të një vendi. Është një masë e përkohshme që justifikohet vetëm kur konkurojnë disa rrethana: niveli i korrupsionit dhe ndikimi politik në gjyqësor janë jashtëzakonisht të larta, masa gëzon mbështetje të gjerë politike dhe publike dhe mjetet dhe mekanizmat ekzistues për të siguruar integritet dhe luftuar korrupsionin e zyrtareve gjyqësore janë ezauruar. Është konsideruar se të gjitha rrethanat e mësipërme janë plotësuar në rastin e Shqipërisë. Në veçanti, Komisioni pasqyroi në raportin vjetor të vitit 2015 për përparimin e vendit në procesin e integritetit evropian se: “trajnimi profesional i gjyqtareve është i papërshtatshëm dhe pavarësia e tyre nuk është e siguruar plotësisht. Nuk ka llogaridhënie të mjaftueshme të gjyqtareve dhe të prokurorëve dhe korrupsioni brenda sistemit të drejtësisë është i përhapur. Vettingu mbështetet gjerësisht nga qytetarët shqiptarë që konsiderojnë si jashtëzakonisht të lartë nivelin e korrupsionit dhe mungesën e profesionalizmit në gjyqësor. Përveç kësaj, ndryshimet e Kushtetutës shqiptare, të nevojshme për realizimin e procesit të reformës në sistemin gjyqësor, gëzonte një mbështetje unanime ndërpartiake.

9. Komisioni i Venecias, i cili u përfshi ngushtë në hartimin e tipareve thelbësore të Vetting-ut, theksoi rëndësinë e Vettingut si më poshtë: “Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për vettingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni i Venecias mbetet i mendimit që masa të tilla jo vetëm që janë të justifikuar, por janë të domosdoshme, që Shqipëria të mbrojë veten nga gerryerja e korrupsionit, i cili nëse nuk adresohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin e saj gjyqësor.”

10. Meqenëse procesi i vettingut mundet, në kushte të caktuara, të kërkojë për të vendosur një sistem gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, një numër vendesh të tjera evropiane aktualisht kanë ndermarre (p.sh. Ukraina) ose kanë konsideruar ndërmarrjen (p.sh. Moldavia dhe Armenia) të një forme të verifikimit ose vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Prandaj, suksesi i Vettingut në Shqipëri mund të japë në të njëjtën kohë një sinjal të fortë për vendet e tjera.

I. Elementet thelbësore të Vettingut.

a. Një skicë e Vettingut dhe roli i Komisionit në të.

11. Procesi i Vettingut kryhet nga tre institucione shqiptare, përkatësisht (i) Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK), anëtarët e të cilit janë emëruar në përgjithësi për pesë vjet dhe që vepron si organi i vettingut të shkallës së parë; (ii) Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA), anëtarët e të

cilit janë emëruar në përgjithësi për nëntë vjet dhe që ka juridiksion të shqyrtoje ankimet kundër vendimeve të arsyetuara të KPK; dhe (iii) dy Komisionerë Publikë (KP), të cilët përfaqësojnë interesin publik në këtë proces. KPA është pjesë e Gjykatës Kushtetuese dhe ndër të tjera ka për detyrë të garantojë të drejtën për një gjykim të drejtë. Modeli institucional që përfshin një KPA është vendosur në mënyrë specifike për të përfshirë rekomandimet e Komisionit të Venecias në Opinionin e tij të fundit për Projekt-ndryshimet kushtetuese për gjyqësorin e Shqipërisë. Siç shpjegohet në detaje më të hollësishme më poshtë, pavaresia dhe paanësia e KPK dhe KPA janë të përfshira në kushtetutën shqiptare dhe garantohen përmes masave mbrojtëse specifike në legjislacionin përkatës.

12. Kushtetuta shqiptare parashikon krijimin e një Operacioni Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). ONM kryen mandatin e tij të monitorimit përmes Bordit Menaxhues (Bordi i ONM) dhe vendosjen e Vëzhguesve Ndërkombëtarë (VN). Ndërsa Bordi i ONM mbikëqyr aspektet e përgjithshme të procesit të vettingut, vëzhguesit nderkombetare monitorojnë të gjitha rastet individuale të verifikimit, si përpara KPK ashtu edhe KPA. Në përputhje me kushtetutën shqiptare, Bordi i ONM drejtohet nga Komisioni, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e administratës së Sh.B.A.

13. Komisioni siguron sekretariatën e përhershëm të ONM, të vendosur në Tiranë dhe që numëron rreth 70 anëtarë të stafit, përfshirë përkthyes, oficerë ligjorë dhe studiues. Që nga viti 2016, ONM ka vendosur si vëzhgues nderkombetare shtatë gjyqtarë dhe prokurorë nga shtetet anëtare të BE-së dhe një nga Shtetet e Bashkuara. Ata janë zgjedhur nga gjyqtarët dhe prokurorët me të paktën 15 vjet përvojë përkatëse dhe ushtrojnë të gjitha funksionet e tyre në pavarësi të plotë.

14. Siç shpjegohet në mënyrë të hollësishme më poshtë, përfshirja e ONM dhe mandati i saj “për të mbështetur procesin e rivlerësimit, duke monitoruar dhe mbikëqyrur tërë procesin e rivlerësimit” sigurojnë mbrojtje të rëndësishme shtesë në drejtim të sigurimit të procesit të duhur dhe respektimit të të drejtave themelore të çdo subjekti të rivlerësimit. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se ONM nuk ka vendimmarrje ose funksione të tjera ekzekutive në procesin e vettingut. Me qëllim të sigurimit të pavaresisë së procesit të Vettingut, as Bordi i ONM-së, as Vëzhguesit nderkombetare nuk marrin ndonjë vendim detyrues që do të ndikonte drejtpërdrejt subjekte individuale të rivlerësimit. Të gjitha fuqitë vendimmarrëse në lidhje me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit i takojnë organeve shqiptare të verifikimit, anëtarët e të cilëve emërohen nga autoritetet shqiptare. Siç është

shpjeguar në menyre te hollesishme më poshtë, ONM në thelb është i autorizuar të marrë informacione përkatëse, të mbikëqyrë saktësinë e procesit të Vettingut dhe të shprehë pikëpamjet e tij për procedurat individuale të vettingut.

15. Komisioni vëren se elementët thelbësorë të Vettingut janë te trefishta:

- KPK është i përbërë nga një personel i pavarur dhe i kualifikuar, i veshur me një mandat të gjere për të ruajtur standardet profesionale, si dhe me kompetencat e nevojshme hetimore dhe vendimmarrëse për të kryer funksionet e tij.
- KPA është ngritur si gjykatë e ligjit dhe vepron si një gjykatë e pavarur, ne te cilen vendimet e KPK mund të kundërshtohen në të gjitha pikat e faktit dhe ligjit.
- ONM dhe vezhguesit e saj nderkombetare janë në një pozitë te plote për të monitoruar dhe raportuar mbi Vettingun në pavarësi të plotë. Roli që kushtetuta shqiptare i akordon ONM-se mbështet besueshmërinë e procesit.

b. Garanton për pajtueshmerine me të drejtat themelore dhe procesin rregullt ligjor.

16. Vetting-u është krijuar nga Parlamenti Shqiptar, i cili mban përgjegjësinë e vetme për të. Sidoqoftë, rregullat e tij janë miratuar gjithashtu me qëllim që të hapin rrugën drejt pranimit të Shqipërisë në BE dhe kjo e fundit kërkon garanci të mjaftueshme për respektimin e vlerave të parashikuara në nenin 2 te TBE, duke përfshirë zbatimin e ligjit dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Si rrjedhim, Komisioni, i cili përputhet me Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, gjithashtu nëse vepron jashtë kornizës ligjore të BE-së, ka mbështetur procesin e Vettingut, përfshirë këtu përmes dhenies së ekspertizës teknike dhe ndihmës financiare. Në mënyrë të ngjashme, Komisioni i Venecias u perfshi ngushtesisht kur Vettingu mori formë dhe ka kontribuar në proces me rekomandimet e tij. Për këto arsye, Vettingu që nga fillimi është orientuar në respektimin e plotë të procesit të rregullt ligjor dhe të drejtave themelore të subjekteve të rivleresimit.

17. Komisioni i Venecias konkludoi në Opinionin e tij të Përkohshëm për Projekt-Ndryshimet Kushtetuese për Gjyqësorin e Shqipërisë, si dhe në raportin e tij të shkurtër Amicus Curiae për Gjykatën Kushtetuese, se Vettingu është përgjithësisht i pajtueshëm me kërkesat e nenit 6 te KEDNJ, duke garantuar se gjithkush ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Në mënyrë të dukshme,

Komisioni i Venecias vlerësoi që: “në masën që rivlerësimi është një masë e përgjithshme, e aplikuar në mënyrë të barabartë për te gjithë gjyqtaret, e vendosur në nivelin kushtetues dhe e shoqëruar me masa të caktuara procedurale dhe që nuk lidhen me ndonjë çështje specifike që një gjykatës mund të ketë para tij/saj, Komisioni i Venecias nuk sheh sesi kjo masë mund të interpretohet se ndikon në pavarësinë e gjyqtarit në një masë të papajtueshme me nenin 6. Kjo nuk përjashton, megjithatë, mundësinë që procedura e rivlerësimit, në një rast të veçantë mund të keqperdoret me qëllim që të ndikojë në pozicionin e gjykatësit në një rast të veçantë: nëse pretendime të tilla provohen, kjo mund të kërkojë rihapjen e asaj çështje të veçantë, pasi gjykatësi nuk do të ishte një gjykatë “e pavarur”.

18. Në vijim, do të përshkruhen faktorët kryesorë që synojnë të sigurojnë përputhjen e procesit të Vettingut me procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat themelore të njeriut, përkatësisht (a) rolin e spikatur që rregullat e vettingut u japin të drejtave themelore dhe procesit të rregullt ligjor; (b) pavarësinë e dhënë organeve të përfshira në Vetting; (c) e drejta e secilit subjekt të rivlerësimit që të kundërshtojë rezultatet negative përpara një gjykate të pavarur; dhe (d) fakti që ONM-s i është dhënë autorizim për të monitoruar Vettingun, për të kontribuar në procedurat e rivlerësimit në mënyrë të njëllojte dhe për të identifikuar mangësitë në raste individuale.

Rëndësia që i kushton procesi i Vettingut të drejtave themelore dhe procesit të rregullt ligjor.

19. Sipas Nenit 179/b paragrafi 2 të Kushtetutës shqiptare, procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë “do të kryhet në bazë të parimeve të gjykimit të drejtë dhe do të zhvillohet duke respektuar të drejtat themelore të subjekteve të rivlerësimit”. Ligji i Vettingut në mënyrë të qartë i referohet nevojës për të mbrojtur të drejtat themelore dhe veçanërisht të drejtat e mbrojtjes gjatë gjithë procesit të Vettingut:

- Sipas nenit 4 paragrafi 5 të Ligjit të Vettingut, KPK dhe KPA “ushtrjnë detyrat e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme bazuar në parimet e barazisë para ligjit, kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe parimeve të tjera, të cilat garantojnë të drejtat e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.”
- Të drejtat e subjekteve të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit janë - sipas nenit 47 të Ligjit të Vettingut - ato të parashikuara në nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të “Kodit të Procedurave

Administrative”, që përfshijnë të drejtën e përfaqësimit, të kontrollojnë dosjen dhe të paraqesin mendime dhe shpjegime. Këto të drejta të subjekteve të rivlerësimit janë shprehur konkretisht edhe në aktet nënligjore të KPK dhe KPA që rregullojnë, ndër të tjera, edhe detaje të procedurës para këtyre organeve të vettingut.

- Neni 55 i Ligjit të Vettingut parashikon në mënyrë të qartë më tej që subjektet e rivlerësimit janë të ftuar në seancë në përputhje me rregullat e Kodit të Procedurave Administrative, se seanca dëgjimore do të mbahet publike, siç parashikohet nga neni 20 i Ligjit “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” dhe që subjekti i rivlerësimit ka të drejtë të refuzojë t’i përgjigjet pyetjeve.

20. Sipas nenit 5 të Kushtetutës shqiptare “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare që është detyruese për të” dhe sipas Nenit 116 dhe 122 të Kushtetutës së Shqipërisë “marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare bëhen pjesë e sistemit juridik të brendshëm të Shqipërisë dhe mbizotërojnë në hierarki mbi ligjet e brendshme”. KEDNJ prevalon si marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare, mbi ligjet e brendshme shqiptare Për më tepër, neni 17 i Kushtetutës shqiptare parashikon që kufizimet e të drejtave të njeriut të mos i tejkalojnë ato të lejuara në KEDNJ.

21. Ka qene vetem për qëllime të ligjshme të rivlerësimit dhe vetëm në masën e nevojshme për të kryer Vettingun që Kushtetuta shprehimisht lejon kufizime të arsyeshme të të drejtave themelore. Në mënyrë të veçantë, neni A, paragrafi i parë i Aneksit të Kushtetutës parashikon “në masën e nevojshme për të bërë rivlerësimin, gamën e aplikimit të disa neneve të kësaj Kushtetute, në veçanti dispozitat në lidhje me privatësinë, duke përfshirë nenet 36 dhe 37 , dispozitat në lidhje me barrën e provës, dhe dispozita të tjera përfshirë nenin 128,131 paragrafi f, 135, 138, 140, 145 paragrafi 1, 147/ a paragrafi 1, germa b, neni 149 /a germa b, janë pjesërisht të kufizuara në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës.”.

Garanton pavarësinë e autoriteteve përgjegjëse për vettingun.

22. Rregullat Shqiptare të Vettingut u japin pavarësi të gjerë autoriteteve përgjegjëse për Vettingun. Aneksi i Kushtetutës shqiptare përcakton në mënyrë të qartë që KPK dhe KPA do të funksionojnë me përgjegjësi, integritet dhe transparencë dhe me objektivin e promovimit të një sistemi gjyqësor të pavarur dhe kompetent, të lire nga korrupsioni. Për këtë qëllim, KPA i është bashkëngjitur Gjykatës Kushtetuese dhe Kushtetuta

shqiptare sqaron se KPA është një Shkalle e Dytë e Gjyqesorit. Rregullat për organizimin e brendshëm të KPK dhe KPA sigurojnë pavarësinë dhe shmangin konfliktin e interesave. Anëtarët e organeve të vettingut nuk mund të mbajnë asnjë pozicion tjetër ose punësim gjatë mandatit të tyre dhe anëtarët e organeve të vettingut janë subjekt i një kontrolli të rreptë të pasurive, transparencës dhe duhet të sinjalizojnë çdo konflikt të mundshëm interesi.

23. Anëtarët e organeve të rivleresimit janë të mbrojtur nga presioni i jashtëm. Gjatë mandatit të tyre, Kushtetuta u jep atyre të njëjtin status ose të anëtarëve të Gjykatës së Lartë (në lidhje me KPK dhe KP) ose të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (në lidhje me KPA). Anëtarët e KPA gëzojnë të drejtën për t'u emëruar si gjyqtare në Gjykatat e Shkallës së Dytë pas përfundimit të mandatit të tyre. Anëtarët e organeve të vettingut dhe këshilltarët e tyre juridikë dhe financiarë kanë të drejtë për një pagë të vleresueshme dhe përfitime të tjera financiare për veprimtaritë e tyre të lidhura me procesin e rivleresimit. Për më tepër, Kushtetuta dhe Ligji i vettingut u jep anëtarëve të organeve të vettingut, stafit dhe familjeve të tyre një nivel të lartë të mbrojtjes personale kundër kërcënimeve për jetën, shëndetin dhe pronën e tyre. Ndërsa anëtarët e organeve të vettingut i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore, rregulli kushtetues që trupat disiplinore duhet të themelohen nga dhe brenda KPA, mbron në mënyrë efektive anëtarët e organeve të rivleresimit kundër presionit të jashtëm të padrejtë. Më në fund, siç shpjegohet më poshtë, pushteti që i jepet ONM jep garanci të mëtejshme për anëtarët e organeve të vettingut që të ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë.

E drejta e ankimit para një organi të pavarur

24. Subjektet e rivleresimit të prekur nga një vendim negativ i KPK kanë të drejtë të bëjnë ankim përpara KPA. Ky i fundit është një organ i pavarur që është “organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankesat kundër vendimeve të Komisionit në përputhje me Aneksin e Kushtetutes dhe Ligjin. Sipas rregullave të vettingut, KPA kryen një rishikim gjyqësor të të gjitha çështjeve të faktit dhe ligjit që janë të rëndësishme për ankimin. Kushtetuta pranon gjithashtu se një ankues i pasuksesshem ka të drejtë të paraqesë një kërkesë në GJEDNJ.

25. Siç vërehet nga Komisioni i Venecias, rregullat në lidhje me procedurën para Koelgjit të Posacme të Apelimit "shkruhen në bazë të kualifikimit të këtij procesi si një “proces gjyqësor” për sa kohe ato parashikojnë zbatimin - ose jo - të rregullave në lidhje me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (shiko, për shembull, nenet 62 (3), 63

(2) dhe 65 (1) te Ligjit të Vettingut). “Në fakt, nenet 62 - 65 te Ligjit te Vettingut parashikojne të drejtën e subjektit te rivleresimit të paraqesë ankim kundër vendimit të KKP dhe që proceset gjyqësore në KPA të zhvillohen në përputhje me rregullat e parashikuara nga neni 47,48/1, 49, 51 dhe 55 të Ligjit Nr 49/2012 “Per organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Përfshirja e ONM

26. Përfshirja e ONM brenda mandatit të saj “për të mbështetur procesin e rivlerësimit duke monitoruar dhe mbikëqyrur tërë procesin e rivlerësimit” siguron masa të rëndësishme shtesë për sa i përket sigurimit të procesit të rregullt ligjor dhe respektimit të të drejtave themelore të secilit subjekt te rivleresimit. ONM është e detyruar të monitorojë saktësinë administrative të te gjithë procesit për emërimin e të gjithë anëtarëve në institucionet e vetingut, si dhe të kontribuojë duke paraqitur, nga një këndvështrim i pavarur dhe i jashtëm, një set te “vlerësimit dhe rekomandimeve të arsyeshme” për të gjithë kandidatët. Rekomandimet e ONM dorëzohen tek autoriteti emërues - Parlamenti i Shqipërisë.

27. Me pak fjalë, kompetencat e ONM janë si më poshtë:

- E drejta për të marrë të gjitha informacionet e rëndësishme: Vezhguesit nderkombetare kanë qasje të menjëhershme në të gjitha informacionet, të dhënat për personat dhe dokumentet e nevojshme për të monitoruar procesin e rivlerësimit në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, me kusht që ata të qëndrojnë brenda objektit të mandatit të tyre dhe respektojnë të drejtat themelore të subjekteve te rivleresimit. Prania e tyre kërkohet në mënyrë të qartë në të gjitha diskutimet në procesin e vendimmarrjes në lidhje me subjektin e rivleresimit, të cilat mbahen pas dyerve të mbyllura dhe ata kanë të drejtë të marrin pjesë në seancat degjimore publike të subjekteve te rivleresimit. Rregullat e vettingut madje i japin fuqi Vezhguesve nderkombetare për të hetuar të gjitha faktet, përfshirë aktivizimin e kanaleve të bashkëpunimit ndërkombëtar, dhe vlerësimin e të gjitha rrethanave që lidhen me procedurën e rivlerësimit.
- E drejta për të bërë gjetje dhe nxjerrë mendime: Gjatë procesit të rivlerësimit, Vezhguesit nderkombetare kanë të drejtë të paraqesin gjetje dhe mendime për çështje të shqyrtuara nga KPK dhe KPA. Konstatimi nga një vezhgues nderkombetar konsiderohet si provë që vërteton se një fakt, kusht., rrethane ose standardi ligjor ekziston ose ka ndodhur; ai ka vlerën procedurale të një raporti ekspertize dhe ai

mund të refuzohet nga KPK ose KPA vetëm me anë të një vendimi të arsyetuar. Ligji i Vettingut parashikon gjithashtu mundësinë që një vëzhgues nderkombetar të paraqesë mendime të shkruara gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat mund të jenë bindëse për organet e verifikimit, por që mund të mos i jepet vlerë provuese.

- E drejta për të paraqitur mendime kundërshtuese. Në përfundim të secilës procedurë të rivlerësimit, Vëzhguesit nderkombetare mund të japin një mendim të kundërtndaj vendimit të dhene nga KPK dhe KPA. Deri me tani, in dy raste, vëzhguesit nderkombetare kanë dhene opinione kunder mbi vendimet përfundimtare për shkarkim nga detyra, të cilat vëzhguesit nderkombetare i kanë bërë publike.
- E drejta për të rekomanduar Komisionerin Publik që të bëjë ankim kundër një vendimi të KPK. Fuqia për të dhene mendime kundërshtuese plotësohet nga fuqia e vëzhguesit nderkombetar për të sugjeruar- përmes përmbajtjes së mendimit kundërshtues ose përmes një rekomandimi zyrtar për të apeluar- të cilat i japin Komisionerit Publik elemente për t'u konsideruar për qëllime të lidhura me ankimin. Rekomandime të tilla, të cilat do të nënshkruhen nga të paktën 3 Komisionere Publike, mund dhe në përgjithësi udhëzojnë Komisionerit Publik. Këta të fundit nuk marrin pjesë në procedimin e shkallës së parë dhe kanë vetëm kohë të kufizuar për t'u njohur me ceshtjen, pasi është dhene vendimi. Nëse Komisionerit Publik vendosin të mos ndjekin rekomandimet e Vëzhguesve nderkombetare për të ankimuar vendimin, ata duhet të lëshojnë një raport me shkrim për të justifikuar vendimin e tyre. Deri më tani, rekomandimet e Vëzhguesve nderkombetare për të apeluar janë mbështetur nga Komisionerit Publik me veprime konkrete të vazhdueshme.
- E drejta për të kërkuar iniciimin e hetimeve disiplinore: Vëzhguesit nderkombetare mund të kërkojnë fillimin e hetimeve disiplinore kundër një Komisioneri Publik, një anëtar të KPK dhe - madje - një gjykatësi të KPA. Hetimi disiplinor zhvillohet më pas nga një komision disiplinor ad hoc, i formuar nga radhët e anëtarëve të KPA me short. Kundër këtij sfondi, Vëzhguesit nderkombetare mund të shihen si garantues të paanshmërisë dhe pavarësisë së procesit të rivlerësimit dhe atyre u jepen kompetenca të ndërhyjnë sa herë që konsiderojnë se anëtarët e organeve të vetingut janë të përfshirë në shkelje disiplinore, përfshirë ato që lindin në rast të vendimeve të marra në situata konflikti interesi.

V. PËRFUNDIM

28. Duke marrë parasysh mungesën serioze të efikasitetit, nivelin e dobët të profesionalizmit dhe korrupsionin e përhapur endemik në të gjithë

sistemin gjyqësor të Shqipërisë, Vettingu është i domosdoshëm për procesin e reformës në vend dhe duhet të ndiqet plotësisht deri në përfundimin e tij, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të ngushtë dhe të pavarur të ONM. Prandaj, dhe duke pasur parasysh elementët e vendosur që kontribuojnë në sigurimin e konformitetit të Vettingut me procesin e rregullt ligjor dhe të drejtat themelore të njeriut, Komisioni konsideron se rregullat shqiptare të Vettingut janë përgjithësisht në përputhje me vlerat e parashikuara në nenin 6 të TBE.

29. Është e vërtetë që ky konformitet i përgjithshëm nuk përjashton që, në raste individuale, rregullat e vettingut interpretohen ose zbatohen në atë mënyrë që nuk është plotësisht në përputhje me kërkesat e procesit të rregullt ligjor dhe të drejtat themelore. Sidoqoftë, Komisioni pohon me respekt se nëse do të identifikoheshin mangësi të tilla, ato duhen korrigjuar pa i vënë në dyshim elementet thelbësore të Vettingut si të tilla. Në këtë drejtim, duhet të kihet parasysh se Vettingu në përgjithësi është i favorshëm për të nxitur një sistem gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, duke mbështetur sundimin e ligjit dhe duke promovuar në këtë mënyrë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

30. Komisioni fton Gjykatën të prezantojë dhe/ose të përdorë informacionin e mësipërm edhe në të gjitha çështjet e tjera të krahasueshme në lidhje me Vettingun dhe veçanërisht në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë (Kërkesa 15227/19). Komisioni mbetet në dispozicion të Gjykatës për sqarime të tjera që Gjykata mund t'i konsiderojë të dobishme.